



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 128/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |         |
|---------------|---------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar  |
| Lindita Skeja | Anëtar  |
| Merita Zeqaj  | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 19.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-86904-02-12-2021, me objekt, “*Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare*” me fond limit 5,227,260.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

**Ankimues:** “Albtelecom” Sha  
*Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Kashar.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër  
*Rruga. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-86904-02-12-2021, me objekt, ”*Shërbimi i internetit në Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare*” me fond limit 5,227,260.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 19.02.2021 operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

*Me datë 15.02.2021, në sistemin e prokurimit elektronik, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkoder, është shpallur procedura kërkesë për propozim shërbime me objekt "Shërbimi i internetit*

*në Bashkinë Qendër, 10 Njësiti Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare". Albtelecom sh.a si palë e interesuar në këtë procedurë, paraqet këtë ankese në lidhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit.*

*Së pari, në lidhje me kriterin:*

*1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet. Në lidhje me përshkrimin pozitiv, referuar kërkesës për paraqitjen e bilanceve të shoqërisë ju lutem referohuni vendimit të K.P.P. 595/2020 ku argumentohet se:*

*Synimi i autoritetit kontraktor me anë të kriterit të mësipërm është përmbushja me sukses e kontratës dhe për realizimin e synimit të mësipërm është parashikuar dorëzimi i bilanceve pozitive për vitet 2018 dhe 2019. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosën që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specifikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. KPP gjykon se qëllimi i normës konkretisht nenit 46 pika 1 gërma "c" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar lidhet me vënien në dispozicion të autoriteteve kontraktore të mekanizmave ligjor mbi vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit me anë të cilave të vërtetohet se operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën. Por ligjvënësi ka parashikuar edhe mjetet ligjore (dokumentacionin ospisonal) që mund të dorëzohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e synimit të normës juridike dhe njëherazi të qëllimit të autoritetit kontraktor si me anë të: deklaratave bankare ose paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. KPP gjykon se kuadri ligjor në asnjë rast nuk parashikon se dorëzimi i bilancit të më shumë se një viti negativ (me humbje) tregon paaftësinë financiare për përmbushjen me sukses të kontratës. Akoma më tej, vetë kuadri ligjor në fushën e procedurave tatimore, ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nuk penalizon në asnjë rast subjektet juridike në ushtrimin e aktivitetit të tyre tregtar edhe në rast se rezulton se bilanci i një ose më shumë viteve rezulton me humbje (pra negativ). Por i vetmi penalizim parashikohet në ligjin nr.8901 datë 23.05.2002 "Për falimentimin", i ndryshuar, në të cilin referuar nenit 14 pika 1 parashikohet se procedura e falimentit hapet me kërkesë të organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë tre vjeçare". Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtë kërkesën e autoriteteve kontraktore mbi dorëzimin e bilancave financiare për tre vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit tregtar ushtrimor, si një e drejtë e cila rrjedh nga ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Por nga ana tjetër, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme lidhet me njohjen e aftësisë së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për të marrë pjesë në qarkullim civil si subjekt tregëtar si edhe duke shfaqur aftësi paguese ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dëshmia, se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite nuk tregon paaftësinë paguese të tij dhe njëherazi rrezikon potencial të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike. Në nenin*

46 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar parashikohet se "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik". Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij në asnjë rast nuk parashikojnë se një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik do të konsiderohet prima facia jo i aftë për përmbushjen e kapacitetit ekonomik në drejtim të përmbushjes së kontratës në rast se rezulton se bilanci i një ose më shumë viti është me humbje (pra negativ), për sa kohë që ky i fundit nuk është subjekt i ndalimeve të parashikuara nga ligji nga ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe ligji nr. nr.8901 datë 23.05.2002 "Për falimentimin", i ndryshuar. KPP ka gjykuar se, referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e bilanceve pozitive nuk është në përputhje me ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nuk është e përshtatshme për realizimin e synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, ndaj dhe KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në përputhje me sa më sipër arsyetuar.

ALBtelecom sh.a gjykon se parashtrimi i kërkeses për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshem, le vend për interpretim dhe nuk lidhet me kërkesen për paraqitjen e bilanceve, rrjedhimisht, kërkojme heqjen e togfjaleshit "aktivitet pozitiv të qëndrueshem" nga ky kriter, dhe riformulimin e kriterit si me poshtë: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuar të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të gërmës "c", të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar."

#### **Se dyti ne lidhje me Kriterin:**

Të ketë të paktën 1(një) lidhje Satelitore Ku-band dhe që lejon lidhjen VPN. (Kotratat ose Marrëveshjet përkatëse) Sqarojmë se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP- në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Gjithshtu në hartimin e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor duhet të mbante parasysh se: Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç

rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në keto specifikime.

Sa me sipër, ALBtelecom sh.a kërkon që autoriteti kontraktor të modifikojë kriterin për lidhje Satelitore Ku-band, duke lejuar edhe teknologji të tjera alternative, të cilat përmbushin nevojat e autoritetit kontraktor për internet, referuar specifikimeve teknike të shërbimit të kërkuar.

**Së treti, në lidhje me specifikimet teknike të shërbimit të kërkuar:**

Përcaktohet se shërbimi i kërkuar është internet me kapacitet (1Gbps / 1 Gbps) për Bashkinë Qendër, sasia 1 cope, si edhe shërbimi internet me kapacitet (1Gbps/1 Gbps) për Njësitë sasia 32 cope, për një periudhë 12 muaj, pra gjithsej në total 33 pika ku do të ofrohet ky shërbim.

Kjo tabele bie ndesh me specifikimet dhe detajimet në tabelat e paraqitura në termat e references ku përcaktohet se kërkohen: Linjat Primare - Bandëith-i linjave të komunikimit, Bashkia Qender me bandwidth 10 GB dhe 30 Njësi me nga 16 Bandwith.

Në këto specifikime nuk është i **qartë numri i pikave ku kërkohet ofrimi i shërbimit**, pasi në tabelën në Shtojcën 10 janë përcaktuar gjithsej 33 pika për shërbimin e internetit, ndërkohë në termat e referencës dhe specifikimet teknike, në çdo rast, **sasia totale e pikave të kërkuara është 31.**

Nuk është e qarte gjithashtu edhe tipologjia e shërbimit të kërkuar në këtë procedurë, pasi nga objekti i tenderit është shprehur qartësisht kërkesa për shërbim interneti, ndërkohë që në paragrafin "kërkesat teknike" fq. 42 DST, është specifikuar se Rrjeti i komunikimit do të bazohet në infrastrukturën Layer 2, teknikisht kjo është një referencë ndaj shërbimit Intranet dhe kjo kërkesë bie ndesh me kërkesat dhe specifikimet e tjera të po të njëjtit dokument ku kërkohet shërbimi Internet për Njësite Administrative, Lagjet dhe Qendrat Komunitare.

Në lidhje me këtë kërkesë ALBtelecom sh.a kërkon, modifikimin e specifikimeve teknike duke paraqitur qartësisht:

1. Shërbimin e kërkuar në përputhje me objektin e procedurës së publikuar: Internet dhe Intranet
2. Sasinë e saktë të pikave dhe kapaciteteve për secilën pikë ku kërkohet shërbimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të administruar pranë KPP me shkresën nr 3970/1 prot., datë 10.03.2021 rezulton se, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik "Albtelecom" Sha me ane te shkrses nr 2989/1 datë 26.02.2021 ka vendosur pranimin tërësisht të saj me argumentin si me poshte vijon;

[...]1) Pretendimi juaj në lidhje me Kriteret e Veçanta të kualifikimit, 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar aktivitet pozitiv të qëndrueshëm është i drejtë dhe pranohet, kjo referuar edhe parashikimeve ligjore të ligjit 9920/2008, I ndryshuar "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

2) Në lidhje me pretendimin tuaj për Në pjesën Kriteret e Veçanta të kualifikimit, 2.3 Për kapacitetin teknik: Të ketë të paktën 1(një) lidhje Satelitore Ku-band dhe që lejon lidhjen VPN,

*qëndron pjesërisht pasi teknologjia Ku-band është një teknologji të cilën shumica e operatorëve e përdorin, dhe nisur edhe nga zgjidhjet teknike që operatorët kanë paraqitur vitet e fundit në procedura të ngjashme të realizuara nga A.K, Bashkia Shkodër, megjithatë morëm parasysh pretendimin dhe hoqëm „Ku-band dhe që lejon lidhjen VPN“ duke lejuar edhe teknologji të tjera alternative për transmetimet satelitore, të cilat duhet të përmbushin nevojat A.K për Internet.*

*3) Pretendimi juaj ne lidhje me pasaktësinë në Shtojcën 10, tek shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit, është i drejtë dhe merret parasysh, pasi nga ana e A.K është bërë një lapsus, dhe për këtë arsye saktësojmë që janë 31 pika për shërbimin e internetit.*

*4) Në lidhje me Shtojcën 11, “Termet e Referencës”, në pjesën Kërkesat teknike: Rrjeti i komunikimit do të bazohet në infrastrukturën Layer 2, është i drejtë dhe merret parasysh. A.K ka vendosur heqjen e këtij kriteri nga DST, duke lejuar kështu edhe përdorimin e infrastrukturave të tjera.*

*Në përfundim të shqyrtimit të ankesës tuaj, vlerësojmë se ajo është e drejtë dhe merret parasysh. Autoriteti Kontraktor do të bëjë korrigjimet e nevojshme dhe do të bëjë modifikimet të cilat do të publikohen me hartimin e një shtojce.[...]*

II.4. Në datën 03.03.2021 operatori ekonomik “Albtelecom” sh.a ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 16.03.2021 nëpërmjet shkresës nr. 3970/1 Prot., datë 10.03.2021 me objekt “Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qëndrat Komunitare”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi dëgjoji relatorin e ceshtjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diksutoi ceshtjen ne tërësi,

#### **Arsyeton**

III.1. Në datën 15.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-86904-02-12-2021, me objekt, ”Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qëndrat Komunitare” me fond limit 5,227,260.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

III.1.1 Në datën 19.02.2021 operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi si më sipër cituar.

III.1.2. Referuar informaciont të autoritetit kontraktor të administruar pranë KPP me shkresën nr 3970/1 prot., datë 10.03.2021 rezulton se, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “Albtelecom” Sha me ane te shkrses nr 2989/1 datë 26.02.2021 ka vendosur pranimin tërësisht të saj. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike KPP vëren se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën me modifikimet përkatëse në përputhje me vendimin e KSHA-së nr. 2989/1 datë 26.02.2021 .

III.1.3. Në datën 03.03.2021 operatori ekonomik “Albtelecom” sh.a ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.4. Në datën 16.03.2021 nëpërmjet shkresës nr. 3970/1 Prot., datë 10.03.2021 me objekt *“Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Referuar sa më sipër lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave te procedures se prokurimit të sipërpërmëndur, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se pretendimet operatorit ekonomik “Albtelecom” sh.a jane pranuar tërësisht nga autoriteti kontraktor duke përmbushur kështu interesin dhe qëllimin e ankimuesit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP nuk shprehet më tej lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesë pasi nuk ka më objekt ankimi.

Gjithashtu në kushtet kur ankesa është pranuar nga autoriteti kontraktor por ende nuk është publikuar në SPE shtojca për modifikim të dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për publikimin e shtojcës për modifikimin e kritereve, në përputhje me konstatimet në shkresën nr. 2989/1 prot datë 26.02.2021, si dhe në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”* Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë”

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pushojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-86904-02-12-2021, me objekt, “Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qëndrat Komunitare” me fond limit 5,227,260.00 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
  2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi sipas konstatimeve të KSHA-së në shkresën nr 2989/1 prot., datë 26.02.2021.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albtelecom” Sh.a
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 377 Protokolli,**

**Datë 03.03.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**